



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË ZYRËS SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.
PËR VITIN 2025**

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. (ZPRK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës., prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZPRK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Rekomandimet synojnë forcimin dhe avancimin e sistemit të kontrolleve të brendshme, veçanërisht në fushat që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, funksionin e auditimit të brendshëm, si dhe menaxhimin/monitorimin e kontratave përmes sistemit e-prokurimi.

Ky raport përmban tre rekomandime, dy rekomandime të reja dhe një është pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Në vitin 2025, buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,253,729€, dhe realizimi ishte gjithashtu 1,253,729€, që përbën 100% të buxhetit të planifikuar.

Çështja C1 - Tejkallim i afateve të parapara ligjore si ushtrues i detyrës

Gjetja Sipas Ligjit nr. 08/L-294, zyrtari publik mund të caktohet si ushtrues detyre deri në 12 muaj, me mundësi vazhdimi edhe për 12 muaj të tjerë vetëm nëse procedura e rekrutimit është shpallur dhe pozita nuk është plotësuar për arsye objektive. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se një periudhë prej 2 viteve.

Në 10 raste, kemi vërejtur që pozitat ishin mbuluar më gjatë se afati i paraparë ligjor prej dy viteve.

Gjatë vitit 2025 ishin zhvilluar procedurat të rekrutimit, mirëpo për shkak të ankesave të njejtat ishin anuluar pas shqyrtimit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndikimi Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga persona që nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara për pozitat adekuate.

Rekomandimi C1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj plotësimin e pozitave me staf të rregullt të punës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja A1 - Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin dhe monitorimin e kontratave

Gjetja

“Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë”.

Në 6 raste nuk ishte përdorur moduli për menaxhimin e kontraktorëve, si dhe nuk ishte kryer monitorimi i vlerësimit të performancës së tyre në sistemin e e-prokurimit.

Kjo situatë ka rezultuar si pasojë e mungesës së njohurive të nevojshme të menaxherëve të kontratave, dhe mbikqyrësve për përdorimin e modulit si dhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe mbështetjes së duhur nga ana e zyrës së prokurimit.

Ndikimi

Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të merr informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

Rekomandimi A1

Sekretari i përgjithshëm duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon vetëm me një anëtar, udhëheqësin e njësisë. ZPRK kishte themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Njësia kishte plan të auditimit strategjik dhe vjetor ku ishin planifikuar të kryhen katër auditime.

Çështja A2 - Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit

Gjetja	<p>Sipas planit vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, Njësia Auditimit të Brendshëm kishte planifikuar ti kryej katër raporte të auditimit.</p> <p>Njësia e Auditimit të Brendshëm kishte përgaditur planin vjetor të auditimit ku kishte planifikuar të kryej katër auditime. Mirëpo, gjatë vitit 2025 kishte realizuar vetëm dy auditime.</p> <p>Sipas Auditorit të Brendshëm, vonesat në realizimin e planit vjetor për vitin 2025 janë si rezultat i angazhimeve shtesë.</p>
Ndikimi	Mos përmbushja e planit vjetor të auditimit zvogëlon nivelin e sigurisë për menaxhmentin mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke rritur mundësinë e identifikimit të vonuar të dobësive dhe praktikave joefektive
Rekomandimi A2	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet se Njësia e Auditimit të Brendshëm vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,134,519	4,877,066	4,367,086	3,136,314	2,379,197
Grante Qeveritare - Buxheti	6,134,519	4,877,066	4,367,086	3,136,314	2,379,197

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,257,453€. Ky zvogëlim është si rezultat i vendimit të qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2025 ZPRK ka shpenzuar 90% të buxhetit përfundimtar, ose 4,367,086€ me një rritje prej 6% krahasuar me vitin 2024.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,134,519	4,877,066	4,367,086	3,136,314	2,379,197
Pagat dhe mëditjet	1,562,093	1,253,729	1,253,729	1,037,736	991,912
Mallrat dhe shërbimet	3,531,421	2,878,729	2,442,915	1,660,593	934,705
Komunalitë	6,700	3,700	2,873	2,696	2,575
Subvencionet dhe transferet	419,305	415,088	414,088	410,728	390,679
Investimet Kapitale	615,000	325,820	253,481	24,561	59,327

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar me vendim të Qeverisë për 308,364€, si rezultat i mos plotësimit të të gjitha pozitave të planifikuara. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 652,692€. Ky zvogëlim i buxhetit ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 85%.
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,000€, Ky shpenzim i ulët është për shkak se ZPRK shfrytëzon objektin e Kuvendit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë edhe shumë shërbime komunale për të cilat paguan Kuvendi, derisa këto shpenzime i parasheh me buxhet në çdo vit.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,217€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 289,180€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 78%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	922	2,571	9,827
Të hyrat tjera	0	0	922	2,571	9,827

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të ZPRK ka rezultuar në dy rekomandime. ZPRK kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'a zbatoj rekomandimin e dhënë dhe kishte dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit për vitin 2025, një rekomandim ishte zbatuar dhe një nuk është zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar ai, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.)


Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj finalizimin e legjislacionit të brendshëm dhe përshtatjes së sistemit të SIMBNJ-së me qëllim të plotësimit të pozitave me staf të rregullt të punës.	ZPRK kishte bërë përpjekje për zbatimin e këtij rekomandimi duke bërë finalizimin e legjislacionit të brendshëm, megjithatë edhe gjatë vitit 2025 kishte pozita me UD.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalimi i kontratës arrin shkallën 30% kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.	Nuk kemi hasur në mangësi të njehta.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Letër Konfirmimi

		REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA E PRESIDENTES - KANCELARIJA PREDSIEDNICE - OFFICE OF THE PRESIDENT
Nr./B/No	02/401-015-0126	
Nr. i fletës/st./No. of pg.		
Data/Datum/Data	08 / 05 / 2026	
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA		



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSIEDNICE

ZYRA E SEKRETARIT - OFFICE OF THE SECRETARY - KANCELARIJA SEKRETARA

LETËRKONFIRMIM

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Fehmi Mehmeti

Sekretar i Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës

Data: 08. Maj, 2026,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.